PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 2
II. BAZA LIGJORE 4
III. ORGANIZIMI 5
III.1 Misioni dhe Objektivat kryesore të Sektorit të AB: 5
III.2 Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm 6
IV. REZULTATET E VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM 6
IV.1 Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese 6
IV.2 Analiza e misioneve të auditimit 10
IV.3 Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre 11
IV.4 Gjetjet kryesore sipas sistemeve 12
V. DETYRIMET E PRAPAMBETURA 16
VI. VLERËSIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM 16
VII. REKOMANDIMET 18
VII.1 Rekomandimet e propozuara nga auditi i brendshëm 18
VII.2 Treguesit rekomandime/auditime viti 2023 21
VIII. ANKETA PËR REAGIMET NGA AUDITIMI. 23
IX. MONITORIMI I SISTEMIT DHE SIGURIMI I CILËSISË SË AUDITIMIT 24
X. ANALIZA E KAPACITETEVE AUDITUESE 25
X.1 Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB 25
X.2 Kapacitetet audituese 27
X.3 Zhvillimi i aftësive dhe ngritja e nivelit profesional të audituesve 27
XI. KONKLUZIONE 28
XI.1 Konkluzione mbi problematikën e punës audituese dhe arritjet 28
XI.2 Prioritetet për vitin e ardhshëm 30

RAPORT VJETOR
MBI VEPRIMTARINË E SEKTORIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AKU-së
PËR VITIN 2023

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Njësia e auditimit të brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, në zbatim të nenit 14, pika "c" dhe "ç" e Ligjit Nr. 114 2015, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", i ndryshuar, ka përgatitur Raportin Vjetor të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022. Në këtë raport, pasqyrohen rezultatet e arritura të auditimit krahasuar me detyrimet e planifikuara vjetore dhe sigurohen të dhëna statistikore, sipas tabelave bashkëlidhur, duke specifikuar një sërë treguesish për arritjet e vitit raportues. Nga auditimet e kryera gjatë vitit 2023, ka rezultuar një nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve si dhe një nivel i lartë i tyre më statusin "***në proces-zbatimi***" Kjo për faktin se një pjesë e rekomandimeve lidhen drejtpërsëdrejti me mbylljen e bilancit vjetor të vitit 2023 dhe gjithashtu evidentohet se për dy organizata angazhimet e auditimit kanë përfunduar në fund të vitit 2023 dhe fillim të vitit 2024 dhe për pasojë zbatimi i rekomandimeve do të vijojë të paktën deri në muajin Mars 2024. Me këtë rast, siç është edhe planifikuar në Planin strategjik dhe vjetor për periudhën 2024-2026, nga Njësia e Auditimit të Brendshëm do të ndërmerret një mision i veçantë auditimi, për të verifikuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve, proces që do të përfundojë me raport, brenda datës 10 Prill 2023.

Gjetjet në total për periudhën raportuese janë në shumën 7,803,374 lekë ndarë respektivisht sipas natyrës së tyre dhe subjekteve të audituara:

1. Gjetjet në vlerë me dëm ekonomik arrijnë në shumën **967,078.lekë**. Respektivisht:
   - DRAKU Korcë → 317,800 lekë
   - DRAKU Tiranë → 396.720 lekë
   - DRAKU Berat → 130,580 lekë
   - DRAKU Elbasan → 59,270 lekë
   - DRAKU Gjirokastër → 42,366 lekë
   - DRAKU Fier → 20,342 lekë

2. Gjetje në vlerë pa dëm ekonomik, në lidhje me përllogaritje të gabuara të amortizimit, gjithsej në shumën: **84.684** l**ekë** respektivisht sipas subjekteve të audituara:
   - DRAKU Elbasan → 60.757 lekë
   - DRAKU Gjirokastër → 23.927 lekë
3. Gjetje për shkelje të disiplinës financiare që kanë të bëjnë me kontabilizim të gabuar të llogarive të aktiveve në shumën **712.372 lekë** respektivisht sipas subjekteve të audituara:
   - DRAKU Elbasan → 156.000 lekë
   - DRAKU Tiranë → 285.450 lekë
   - DRAKU Korcë → 50.300 lekë
   - DRAKU Gjirokastër → 132.680 lekë

- DRAKU Fier → 373.392 lekë

4. Gjetje për vlerësimin e parregullt të aktiveve që kërkohen të dalin nga përdorimi në shumën totale **2.767.890 lekë**, respektivisht sipas DRAKU-ve (njësive të vartësisë)

   - DRAKU Vlorë → 157.684 lekë
   - DRAKU Elbasan → 1.128.444 lekë
   - DRAKU Tiranë → 718.910 lekë
   - DRAKU Korcë → 162.412 lekë
   - DRAKU Gjirokastër → 456.264 lekë
   - DRAKU Fier → 863.086 lekë

5. Gjetje me efekte negative (gjoba të parashkruara dhe moskuadrime me thesarin) gjithësej: **2.433.480 lekë**
   - DRAKU Korcë → 1.850.000 lekë
   - DRAKU Gjirokastër → 583.480 lekë (570.000 lekë gjoba)

6. Gjetje me efekte negative (pasqyruar gjëndje magazine më pak në bilancet kontabël, krahasuar me hyrjet dhe daljet respektive)
   DRAKU Gjirokastër → 491.220 lekë
7. Gjetje për debitor të pa pasqyruar në Bilancin kontabël
   DRAKU Tiranë → 346.650 lekë

***Auditi, nisur nga gjetjet dhe struktura e tyre ka arritur në konkluzionin se ato kanë ardhur kryesisht nga*:**

1- Mosfunksionimi i kontrollit të brendshëm.
2- Kuptime të gabuara të ligjeve dhe akteve të tjera në fuqi.
3- Mungesa e bashkëpunimit midis DRAKU-ve dhe strukturave të veçanta në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së.
4- Mangësi në marrjen dhe dorëzimin e detyrës.
5- Mungesa e trajnimeve ne fushën e Kontrollit të Brendshëm për menaxherët e njësive.

Gjatë vitit 2023 janë planifikuar për tu audituar gjithsej 9 (nëntë) organizata. Gjithashtu me kërkesë së Menaxhimit të Lartë me Urdhrin nr.177 datë 12.01.2023 u krye Auditimi i " Listëpagesave dhe listëprezencave në DRAKU/Berat për vitin 2022". Për këtë ndryshim është njoftuar dhe Komiteti i Auditimit. Në vitin 2023 kanë filluar gjithsej 8 angazhime auditimi dhe kanë përfunduar 7 prej tyre brenda vitit, duke veçuar një njësi vartësie për të cilën Projekt raporti ka përfunduar në muajin Janar 2024. Në planin e auditimeve ishte përfshirë edhe Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së "Auditim Financiar", por auditi nuk vijoi sepse Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së u auditua nga KLSH me temë: "Auditim i përputhshmërisë" duke përfshirë edhe aspektet e menaxhimit financiar.

Përfundimisht nga 9 auditime të planifikuara janë realizuar 7 dhe se 1 (një) auditim është kryer me urdhër të menaxhimit të lartë. Theksojmë se një auditim vijon gjatë muajit Janar 2024, i cili është auditim i planifikuar për vitin 2023, por të dhënat për këtë auditim nuk përfshihen në këtë raport.

Evidentojmë gjithashtu se nga ana e NJAB, është kryer edhe misioni i auditimit, i cili ka të bëjë me statusin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna gjatë auditimeve të kryera për vitet 2022-2023, angazhim ky që ka filluar me nismën e Ministrisë Financave. Për këtë mision sqarojmë se është paraqitur një raport i veçantë, për Ministrisë e Financave, ku përgjithësisht në lidhje me situatën e zbatimit të rekomandimeve sqarojmë:

Nga auditimet e përfunduara për vitin **2023** jo të gjitha subjektet i janë përgjigjur zyrtarisht, nëpërmjet planeve të veprimit. Janë dhënë rekomandime për përmirësimin e punës dhe ndreqjen e parregullsive si dhe për të ndihmuar njësitë e audituara në realizimin e misionit dhe objektivave të tyre për drejtimin dhe zhvillimin me efektivitet të funksioneve publike, rritjen e efiçencës së përdorimit të fondeve buxhetore. Burimet e auditimit kanë qenë në përputhje me planifikimin dhe përgjithësisht kanë marrë pjesë i gjithë stafi auditues në auditimet e realizuara për vitin raportues. Sektori i auditimit të brendshëm për vitin 2023 ka vijuar punën e tij dhe ka rritur asistencën e tij profesionale në ndihmë të përmirësimit të drejtimit dhe shtimit të vlerës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së dhe të njësive në vartësi të saj, duke planifikuar veçanërisht për auditim ato njësi, aktivitete apo fusha me risk të lartë, referuar misionit të veprimtarisë së Institucionit, që kanë të bëjë me rritjen e sigurisë ushqimore. Në përfundim të çdo misioni auditimi janë dhënë rekomandimet përkatëse, organizative, masa për përmirësimet e sistemit dhe masat për zhdëmtim dëmi. Rekomandimet natyrisht janë klasifikuar sipas riskut të tyre dhe janë paraqitur në planet e veprimit për çdo organizatë.

Rekomandimet nga pikëpamja e nivelit të riskut paraqiten:

- Rekomandime më risk të lartë → **119**
- Rekomandime me risk të mesëm → **73**
- Rekomandime me risk të ulët → **12**
- **Totali** → **204**

Në auditimet e zhvilluara ka marrë pjesë përgjithësisht i gjithë stafi i auditimit.

Raporti siguron të dhëna statistikore të paraqitura në grafikët dhe tabelat, të cilat janë hartuar sipas formatit të unifikuar, duke specifikuar treguesit e arritur dhe të evidentuar nga raportet e auditimit të përfunduara për këtë periudhë.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për vitin 2023 është kontrolluar nga struktura të tjera, jashtë institucionit (KLSH, etj), auditim i "*Përputhshmërisë*" i cili ka filluar në muajin Prill të vitit 2023 dhe ka përfunduar në muajin Nëntor si Projekt Raport.

II. BAZA LIGJORE

❖ **Kuadri ligjor dhe procedural i Auditimit të Brendshëm përbëhet nga:**

- Ligji Nr. 114 2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar me Ligjin 12 datë 02.02.2023.

- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Urdhri i Ministrit të Financave Nr.100, datë 25.10.2016, "*Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik";*
- Urdhri Nr. 86, datë 10.12.2015 "Kodi i etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik";

❖ **Kuadri ligjor i veprimtarisë të subjekteve të auditim**:

- Ligji 9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar
- Ligji 10433 datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Re[ublikën e Shqipërisë"
- Ligji 10416 datë 07.04.2011 " Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor" i ndryshuar
- Ligji 87/2012 "Për Miratimin e Aktit Normativ nr.4 datë 16.08.2012 të Këshillit të Ministrave " Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimit të mishit të tyre"
- Ligji 105/2016 "Për mbrojtjen e Bimëve" i ndryshuar.
- Ligji 17/2020 "Për Produktet Plehëruse"
- VKM 1081 datë 21.10.2009, ndryshuar me VKM nr.708, datë 09.09.2020 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e AKU*",
- VKM 434 datë 11.07.2018 " Për Miratimin e Rregullave për Etriketimin e Produkteve Ushqimore"

Në ushtrimin e veprimtarisë audituese, Sektori i Auditimit të Brendshëm në AKU, i është përmbajtur dhe i përmbahet parimeve, drejtimeve dhe objektit të Auditimit të Brendshëm të përcaktuara në Kreun II nenet, 5, 6 dhe 7 të Ligjit në fuqi mbi Auditimin e Brendshëm dhe në kërkesat e parashikuara në aktet e mësipërme. Gjithashtu, gjatë ushtrimit të veprimtarisë audituese janë mbajtur për referencë edhe të gjitha aktet që rregullojnë veprimtarinë e Organizatave të audituara, si në fushën e menaxhimit financiar por edhe të proceseve dhe vecanërisht në fushën e sigurisë ushqimore.

III. ORGANIZIMI

III.1 Misioni dhe Objektivat kryesore të Sektorit të AB:

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm si veprimtari e pavarur mbështet menaxhimin e Lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së dhe të Drejtorive Rajonale të AKU-së, për arritjen e objektivave të tyre, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë. Në funksion të përmbushjes së misionit të tij, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese kanë qenë:

- Angazhim për zbatimin e planit.
- Vlerësimi i ngritjes dhe funksionimit të kontrollit të brendshëm sipas sistemeve.
- Kualifikimi i vijueshëm i stafit.
- Zbatimi i standardeve të auditimit.
- Rritjen e besueshmërisë, objektivitetit, pavarësisë në veprimtarinë e saj audituese.

- Këshillimet e specializuara dhe profesionale gjatë gjithë procesit të auditimit.

***Të japë siguri të arsyeshme nëse*:**

- Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacionale janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur.
- Burimet financiare janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri.
- Aktivet janë ruajtur dhe mirëmbajtur.
- Veprimtaritë e kryera nga Drejtoritë Rajonale të AKU-së janë në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe udhëzimet e miratuara.
- Objektivat kryesore të përcaktuara në programet dhe planet e punës janë arritur.
- Rekomandimet e dhëna kanë qenë cilësore dhe efiçente për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së strukturave të audituara.

Roli dhe misioni i auditimit të brendshëm ka qenë më shumë i fokusuar dhe i përqëndruar që të drejtojë burimet e auditimit drejt së ardhmes sesa ngjarjes së kaluar (veprime tashmë të ndodhura në të kaluarën), duke dhënë sipas rasteve specifike, rekomandimet dhe këshillimet e nevojshme me qëllim përmirësimin e sistemeve dhe proçeseve në të ardhmen.

III.2 Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm

Sektori i Auditimit të Brendshëm është organizuar si Sektor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së. Ky sektor ka në përbërjen e tij tre punonjës sipas strukturës së miratuar (1+2) 100% të certifikuar. Gjatë periudhës raportuese, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar e plotë nga pikpamja e stafit në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Gjatë periudhës raportuese stafi i njësisë së auditimit, ka ndjekur trajnimet e vijueshme për temat e kërkuara, të cilat janë paraqitur në planin vjetor dhe strategjik. Trajnimet janë realizuar nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Sqarojmë se në muajin Dhjetor 2023 ka ndodhur një ndryshim në stafin e specialistëve të auditimit, ku një prej tyre është transferuar në një detyrë tjetër dhe në zëvëndësim është emëruar një specialist tjetër, i cili nuk ka akoma certifikatën e Auditimit të Brendshëm, por që në vijim, do të kryejë procesin referuar kohës që parashikon edhe ligji organik.

Në zbatim edhe të udhëzimeve të Ministrisë Financave, ditët e qëndrimit në subjekt kanë qenë racionale, me qëllim uljen e kostove të auditimit.

IV. REZULTATET E VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

IV.1 Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese

Në zbatim të germës "a" të Nenit 6, germa 'c" e Nenit 14 të Ligjit Nr. 114/2015, datë 23.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar dhe të kapitullit 3, dhe standardit 2010 "Planifikimi" të manualit të auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave, Nr. 100, datë 25.10.2016. "*Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në*

sektorin publik", Njësia Audituese në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ka përgatitur planin vjetor dhe strategjik për periudhën 2024-2026.
Gjatë vitit 2023 njësia e auditimit të brendshëm i është përmbajtur përgjithësisht programit të miratuar duke mbuluar me auditim të gjitha subjektet e saj, të cilat lidhen me misionin dhe qëllimin për të cilën ajo funksionon.
Gjatë të gjitha misioneve të angazhimit, stafi audites është përqëndruar në auditimin e sistemeve dhe vlerësimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim përcaktimin nëse ato funksionojnë me kosto efektive, në mënyrë eficente për arritjen e objektivave të institucionit. Në të gjitha angazhimet është kryer procesi i vlerësimit të riskut veçanërisht gjatë programit dhe njëkohësisht duke mbajtur parasysh dhe historikun e njësisë së audituar, mjedisin e kontrollit si dhe parregullsitë apo problemet e konstatuara në vitin paraardhës. Në hartimin e planit është mbajtur parasysh stafi i njësisë së auditimit, përgjegjësitë individuale për secilin audites, kohëzgjatja e auditimit si dhe sigurimi i cilësisë së auditimit. Programi dhe tematikat e auditimit për subjektet e audituara janë mbështetur në kriteret e mëposhtme;

- Përfshirja në plan e subjekteve që mbartin risk të lartë;
- Përcaktimi i frekuencës së auditimit (për fusha me risk të lartë dhe të mesëm) për jo më pak së 1 herë në 2 vjet ose 1 vit.
- Marrja në konsideratë e rezultateve përfundimtare të auditimeve të mëparshme;
- Dhënien prioritet të sistemeve dhe fushave për të cilat ka interesim të posaçëm nga menaxhimi i lartë që lidhen drejtpërsëdrejti me misionin e institucionit.
- Përcaktimi i frekuencës për fusha që janë konsideruar me risk të ulët, për të cilat nuk duhet të kalojë një afat i caktuar (jo më shumë se 5 vjet).

Një drejtim mjaft i rëndësishëm gjatë veprimtarisë audituese ka qënë dhe zbatimi i standardeve të auditimit. Ky proces është karakterizuar nga;

- Njohjen e natyrës së subjektit që auditohet, veçoritë e tij, referuar kjo edhe tërësisë së problematikave të Institucionit, në të gjithë shtrirjen e tij.
- Përcaktimin e drejtimeve dhe çështjeve që duhet të mbulojë auditimi;
- Vlerësimin e riskut dhe materialitetit;
- Transparencën dhe metodën e ballafaqimit me punonjësit;
- Objektiviteti dhe paanësia në vlerësim;
- Përgatitjen e dokumentacionit të auditimit dhe masat rekomanduese.

Në zbatim të kërkesave të nenit 9, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 114 2015, datë 23.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" i ndryshuar, auditimet e kryera gjatë vitit 2023 kanë qenë auditime kryesisht me bazë sistemi.
Sipas programit vjetor 2023, janë planifikuar të kryhen gjithsej **9** auditime, respektivisht:

- **Auditime të Pëputhshmërisë**

1. Zbatimi i rekomandimeve.

- **Auditime të Kombinuar (përputhshmërisë dhe Financiar)**

1. Drejtoria Rajonale e AKU-së Vlorë;

2. Drejtoria Rajonale e AKU-së Elbasan;
3. Drejtoria Rajonale e AKU-së Tiranë;
4. Drejtoria Rajonale e AKU-së Korcë;
5. Drejtoria Rajonale e AKU-së Gjirokastër;
6. Drejtoria Rajonale e AKU-së Fier
7. Drejtoria Rajonale e AKU-së Berat

- **Auditime Financiare**

1.Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së

Gjatë vitit 2023, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka kryer gjithsej **8 (tetë)** misione auditimi, nga të cilat **7** (**shtatë**) prej tyre janë sipas planit vjetor, ndërsa 1 auditim me urdhër të Menaxhimit të Lartë për ***"rregullshmërinë e listëpagesave"*** në Drejtorinë e Rajonale të AKU-së Berat.
Evidentojmë se për një subjekt procedurat përfundimtare, mbyllen në fund të muajit Janar 2023, por të dhënat mbi gjetjet dhe konkluzionet janë përfshirë në këtë raport.

Më poshtë tabela e realizimit të auditimeve për vitin 2023 dhe historiku i tyre.

Tabela nr. 3: Realizimi i programit të auditimeve për vitin 2023.

Viti	Auditime të relaizuara gjithsej	Auditime të realizuara sipas programit	Auditime me kërkesë të Menaxhimit të Lartë	Auditime të programuara
2023	**8**	**7**	**1**	**9**

Realizimi i programit të auditimeve për vitin 2022

Viti	Auditime të relaizuara gjithsej	Auditime të realizuara sipas programit	Auditime me kërkesë të Menaxhimit të Lartë	Auditime të programuara
2023	**8**	**7**	**1**	**8**

Sic vërehet realizimet nga pikpamja numerike pothuajse janë në plotësim të planit, duke përjashtuar vitin 2023, ku sic kemi shpjeguar një auditim nuk është kryer, për faktin se subjekti i planifikuar u kontrollua gjatë vitit 2023 nga KLSH.
Evidentojmë gjithashtu se gjatë auditimeve të vitit 2023, për dy organizata është kërkuar shtyrje e procesit, për shkak të problematika të hasura dhe ky fakt konstatohet edhe me gjetjet e evidentuara.
Sa i takon faktit të planifikimit gjatë auditimeve dhe realizimit të fushave të audituara, më poshtë në mënyrë tabelore situata për çdo subjekt të audituar;

Tabela nr. 4: Planifikimi dhe realizimi i fushave të audituara.

Subjekti i audituar	Planifikuar		Realizuar	
	Lloji auditimit	Sisteme /fusha për auditim	Lloji auditimit	Sisteme /fusha për auditim
Zbatimi i rekomandimeve për vitet 2021-2022	I përputhshmërisë	1	I përputhshmërisë	1
DRAKU Berat	I përputhshmërisë	1	I përputhshmërisë	1
DRAKU Elbasan	I Kombinuar	9	I Kombinuar	9
DRAKU Vlorë	I Kombinuar	11	I Kombinuar	11
DRAKU Tiranë	I Kombinuar	11	I Kombinuar	11
DRAKU Korçë	I Kombinuar	11	I Kombinuar	11
DRAKU Gjirokastër	I Kombinuar	11	I Kombinuar	11
DRAKU Fier	I Kombinuar	11	I Kombinuar	11
DRAKU Berat	I Kombinuar	11	Në proces	11
DP AKU	Financiar	7	I pa realizuar	0
Total Sisteme / Fusha		**84**		**77**

Sistemet dhe fushat e planifikuara dhe të audituara janë:

1. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna gjatë viti 2021-2022-2023;
2. Plani dhe realizimi i inspektimeve me bazë risku në terren si dhe plani i marrjes së mostrave dhe realizimi nga inspektorët e terrenit dhe PIK;
3. Rakordimi i të ardhurave me zyrën e financës/Strukturat që krijojnë të ardhurat/Degën e thesarit;
4. Debitorët dhe detyrimet e prapambetura;
5. Procesi i aplikimit të tarifave për inspektimet e kryera në regjimin import/eksport/tranzit, tarifat nga lëshimi i certifikatave veterinare;
6. Administrimi i aktiveve/inventar/magazinë;
7. Zbatimi i procedurave të prokurimeve publike për blerje mallrash dhe shërbimesh;
8. Administrimi i karburantit për automjetet dhe kaldajat;
9. Procedurat dhe afatet e notifikimit të etiketave;
10. Vlerësimi i masave administrative në formën e gjobës;
11. Respektimi i strukturës dhe organikës, pagat, shtesat mbi pagë si dhe verifikimi i pagëses së vjetërsisë dhe diplomës;
12. Administrimi/përdorimi i dokumentacionit PIK;
13. Pagesat e kryera për Udhëtime dhe dieta (brenda vendit);

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, të dhëna gjatë vitit 2023 nuk janë ndërmarrë misione të veçanta por është mbajtur kontakt me njësitë e audituara për zbatimin e tyre, referuar edhe planeve të veprimit. Për rekomandimet e zbatuara është verifikuar edhe dokumentacioni i nevojshëm që provon zbatimin e tyre. Prioritet në këtë proces kanë qenë rekomandimet me nivel risku të lartë.

Ndërkohë siç kemi theksuar nga NJAB, do të ndërmerret një mision i veçantë për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, mision i cili do te fillojë dhe përfundojë deri në datë 10 prill 2024.

IV.2 Analiza e misioneve të auditimit

Siç u theksua dhe më sipër, në programin vjetor janë planifikuar për tu realizuar **9** auditime përkatësisht **1** për Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së dhe **8** për Drejtoritë Rajonale të AKU-ve. Janë realizuar **8** auditime, sipas planifikimit. **1** auditim nuk është realizuar (Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së), meqënëse u kontrollua nga KLSH, ndërsa 1 auditim ka filluar në fillim të muajit Janar 2024, për llogari të vitit 2023 dhe përfundimi i punës në terren përfundon në dt.02.02.2024.(I planifikuar në vitin 2023)

Sqarojmë gjithashtu se për dy subjekte ka pasur shtyrje të kohës së auditimit, për shkak të problematikave të konstatuara dhe kjo ka sjellë si pasojë edhe zhvendosjen në kohë për subjekte pasardhëse në auditim.

Gjithashtu ka pasur edhe ndryshim të Menaxhimit të Lartë në muajin Tetor 2023 dhe kjo situatë mori kohën e nevojshme për vlerësim të raporteve në proces.

Për vitin 2023, numri i auditimeve të programuara dhe të realizuar sipas natyrës së tyre, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 5: Numri i auditimeve të realizuara sipas natyrës së tyre.

Nr.	Emërtimi	Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara
1	Auditime të përputhshmërisë	1	1
2	Auditime të kombinuara	7	7
3	Auditime financiare	1	0
TOTALI		**9**	**8**

Misione auditimi të evaduara;

1. Drejtoria Rajonale e AKU-së Tiranë
2. Drejtoria Rajonale e AKU-së Vlorë
3. Drejtoria Rajonale e AKU-së Elbasan;
4. Drejtoria Rajonale e AKU-së Korcë;
5. Drejtoria Rajonale e AKU-së Gjirokastër ;
6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, duke përfshirë të gjitha strukturat e vartësisë për auditimin, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve;
7. DRAKU/Berat , auditim me urdhër të Menaxhimit të Lartë.
8. Drejtoria Rajonale e AKU-së Fier

b) Misione auditimi në proces, dërguar projekti muaji Janar 2024.

1. Drejtoria BERAT,

IV.3 Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre

Njësia e auditimit të brendshëm në planet strategjike vjetore ka identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e subjekteve audituese. Në ligjin për auditimin e brendshëm dhe manualin e procedurave, janë përcaktuar dhe metodologjitë që përdoren për vlerësimin e riskut dhe në referim të tyre njësia e auditimit të brendshëm programon dhe auditimin e fushave dhe subjekteve që paraqiten me një nivel të lartë risku. Nga analizat e raporteve vjetore individuale të strukturave audituese si në konsultim me Menaxhimin e Lartë, por dhe takimet e ballafaqime të ndryshme me punonjës, apo struktura të Institucionit është bërë e mundur marrja në konsideratë e faktorëve të riskut të cilët në mënyrë të përmbledhur grupohen sipas kategorive të mëposhtme:

- Sasia dhe përdorimi i burimeve në dispozicion të subjektit të audituar;
- Zbatimi i ligjshmërisë, procedurave, rregulloreve e planeve;
- Ruajtja dhe miradministrimi i aseteve pronë e subjektit publik;
- Funksionet kryesore, organizimi dhe kompleksiteti i subjekteve që auditohen;
- Mjedisi i kontrollit të Brendshëm, në subjekte;
- Shkalla e shpeshtë e ndryshimeve organizative dhe në drejtim;
- Shkalla e dobët e monitorimeve për proceset;
- Mbulimi i pamjaftueshëm me auditime në të kaluarën (për sisteme të veçanta);

Referuar faktorëve të përmendur më sipër, njësia e AB-së ka vlerësuar me risk të lartë fushat sistemet si më poshtë:

- Zbatimi i rekomandimeve të dhëna gjatë viti 2022;
- Plani dhe realizimi i inspektimeve me bazë risku në terren si dhe plani i marrjes së mostrave dhe realizimi nga inspektorët e terrenit dhe PIK;
- Procesi i Notifikimit të Etiketave
- Rakordimi i të ardhurave me zyrën e financës/Strukturat që krijojnë të ardhurat/Degën e thesarit;
- Debitorët dhe detyrimet e prapambetura;
- Procesi i aplikimit të tarifave për inspektimet e kryera në regjimin import/eksport/tranzit, tarifat nga lëshimi i certifikatave veterinare;

Në referim të përcaktimit të fushave me risk të lartë të përmendura më sipër, njësia e AB-së ka vendosur prioritetet e saj. Kështu në subjektet apo fushat me risk më të lartë janë angazhuar dhe burimet kryesore të auditmit, që do të thotë që në këto auditime është përfshirë i gjithë stafi, është siguruar koha e mjaftueshme për vlerësimin e subjekteve. Në rastet kur njësia e AB-së kanë vlerësuar drejt riskun që në fazën e planifikimit, këto fusha janë përfshirë në prioritetet e planit vjetor. Është mbajtur në konsideratë që për të gjitha subjektet e audituara, janë prekur të gjitha fushat.

Atje ku risku është vlerësuar i një niveli të lartë, i është kushtuar vëmendje edhe procesit të ndjekjes së rekomandimeve, duke synuar jo vetëm përcaktimin e efekteve të shkaktuara apo përgjegjësive, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin e përsëritjes së fenomeneve të tilla në të ardhmen.

- **Referuar vlerësime të riskut, nga auditimet ka rezultuar se ato kanë qenë drejtë të vlerësuara si të tilla dhe konkretisht,**

NR.	Proceset e audituesshme	Risku	Fakti
1	Plani dhe realizimi i inspektimeve me bazë risku në terren si dhe plani i marrjes së mostrave dhe realizimi nga inspektorët e terrenit dhe PIK.	**I Lartë**	Nga auditimet ka rezultuar se plani i inspektimeve dhe ai I marrjes së mostrave me bazë risku është realizuar në masën 70 %
2	Dokumentacioni shoqërues për produktet që hyjnë në territorin e vendit, nëpërmjet Pikave të Kalimit Kufitar dhe doganat e brendshme. Aplikimi i tarifave të shërbimit dhe rakordimi i tyre.	**I Lartë**	Janë konstatuar gjetje sa i përket në këtë fushë në katër subjekte të vartësisë dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse. Janë konstatuar gjetje në lek për aplikime të gabuara të tarifave si dhe mos rakordimi i tyre me degët e thesarit përkatëse.
3	Ndjekja e realizimit të detyrave të lëna gjatë procedurës së inspektimit.	**I Lartë**	Konstatuar nivel shumë i ulët i kryerjes së inspektimeve për realizimin e detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm (jo më tepër se 20% inspektime të kryera).
4	Procedurat dhe afatet e notifikimit të etiketave	**I Mesëm**	Janë konstatuar mosndjekje të procesit për rastet kur etiketa është konstatuar jo në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe subjekti nuk ka paraqitur etiketën e re për notifikim.
5	Administrimi i aktiveve inventar / magazinë.	**I Mesëm**	Janë konstatuar parregullsi sa i përket vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi dhe administrimit të magazinës. Për këto gjetje janë dhënë rekomadimet përkatësë në subjektet e audituara.
6	Zbatimit të procedurave të prokurimeve publike për blerje mallrash dhe shërbimesh.	**I Mesëm**	Janë konstatuar mangësi në procedurat e blerjeve të vogla, kryesisht në argumentimin e fondit limit dhe administrimit të dokumentacionit të dosjes së prokurimit.
7	Respektimi i strukturës dhe organikës, pagat, shtesat mbi pagë, si dhe verifikimi i pagesës së vjetërsisë dhe diplomës.	**I Mesëm**	Janë konstatuar parregullsi për tre subjekte të audituara dhe është rekomanduar kthimi i shumës së përfituar padrejtësisht.
8	Pagesat e kryera për udhëtime e dieta brenda vendit.	**I Mesëm**	Janë konstatuar parregullsi në dy subjekte, por vlera ka qënë e ulët
9	Administrimi i karburantit.	**I Mesëm**	Është konstatuar mungesë dokumentacioni vërtetues për shërbimet e kryera me automjetet zyrtare dhe është rekomanduar zhdëmtimi për çdo rast.
10	Administrimi / përdorimi i dokumentacionit zyrtar në PIK.	**I Mesëm**	Nuk janë konstatuar raste në administrimin e dokumentacionit nga inspektorët e PIK, por mangësi në procesin e dorëzimit të dokumentacionit nga ana e magazinierit, në dy subjekte të audituara.

IV.4 Gjetjet kryesore sipas sistemeve

Gjatë veprimtarisë së tij audituese stafi i njësisë së AB ka evidentuar elementët e dobët dhe jo funksional të sistemit të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi,

frytshmëri të fondeve publike, mbledhjes së të ardhurave si dhe proceseve. Nga kjo veprimtari gjetjet kryesore të rezultuara sipas sistemeve fushave janë:

- Në fushën e procedurave të inspektimit, në terren;
- Në realizimin e planeve të inspektimit dhe marrjes së mostrave në PIK dhe terren;
- Në mos kontrollin e detyrave të lëna nga inspektimet
- Në proceset e notifikimit të etiketave;
- Në ndjekjen e procedurave për arkëtimin e gjobave të aplikuara;
- Në fushën e prokurimeve publike dhe administrimit të karburantit;
- Në përllogaritje e normave të amortizimit;
- Në fushën e aplikimit të tarifave për shërbimet në PIK;
- Në monitorimin e realizimit të planeve të inspektimit dhe marrjes së mostrave nga DP;
- Në sistemin për ruajtjen, administrimin e aktiveve si dhe dokumentacionit dhe arkivimin e tij;
- Në fushën e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, në të gjithë elementët e tij;
- Në marrjen dhe dorëzimin e detyrës;
- Në zbatimin e rekomandimeve.

Për periudhën raportuese, viti 2023, gjetjet me dëm ekonomik arrijnë në shumën 967.078 lekë, e cila është e ndarë sipas fushave apo sistemeve si më poshtë:

Në fushën e administrimit të karburantit	359,524	lekë
Në fushën e pagave.	244,314	lekë
Në fushën e tarifave të aplikuara	298,100	lekë
Në fushën e shpenzimeve për udhëtime e dieta	33,000	lekë
Të tjera (mosrakordime, magazinë dhe të ardhura)	32,140	lekë
Totali	**967,078**	**lekë**

Grafiku nr 1: Gjetjet në vlerë me dëm ekonomik, ndarë sipas fushave



Tabela nr. 6: Vlera e gjetjeve të konstatuara sipas Drejtorive Rajonale dhe statusi i tyre.

Emri Subjektit	Shuma rekomanduar për zhdëmtim dëmi	Shuma e arkëtuar	Diferenca për tu arkëtuar
DRAKU Korçë	317,800	283,750	34,050
DRAKU Tiranë	396,720	304,820	91,900
DRAKU Berat	130,580	74,365	56,215
DRAKU Elbasan	59,270	4,020	55,250
DRAKU Gjirokastër	42,366	24,286	18,080
DRAKU Fier	20,342	0	20,342
Totali	**967,078**	**691,241**	**275,837**

Grafiku nr 2: Gjetjet në lekë të konstatuara sipas Drejtorive Rajonale.



Për kategorinë e gjetjeve të paraqitur më sipër, vlerësohet se peshën kryesore e zënë gjetjet në ato fusha apo sisteme të cilat janë reflektuar në planet e njësisë së auditimit të brendshëm si fusha me risk të Mesëm. I gjithë totali i zbulimeve apo gjetjeve është lënë për zhdëmtim nga personat përgjegjës. Nisur nga zbulimet edhe natyra e rekomandimeve i referohet gjetjeve të auditimit për evidentimin, rregullimin dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, parandalimin e shkeljeve, ruajtjen e aseteve publike si dhe zhdëmtimin e vlerave të shkaktuara nga persona përgjegjës ose të përfituara padrejtësisht.

Vlen të theksohet se në lidhje me masat e ndërmarra për zhdëmtimet e vlerave që auditi ka rekomanduar, nga subjektet e audituara përgjithësisht ato janë pranuar dhe janë zhdëmtuar një pjesë e tyre dhe pjesa tjetër do të vijojë për arkëtim në favor të buxhetit të shtetit.

Realizimi i arkëtimeve është në masën 72%

Në referim të gjetjeve, natyra e rekomandimeve i është referuar pikërisht atyre, qëllimi i të cilave ka qenë rregullimi dhe përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, parandalimin e shkeljeve, si dhe administrimit të të ardhurave.

Në këtë proces NJAB-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm për faktin se ka ndjekur, në mënyrë të vazhdueshme situatën për zbatimin e rekomandimeve jo vetëm të atyre organizative por veçanërisht edhe atyre që kanë të bëjnë me zhdëmtim dëmi.
Në vlerësimet e auditit konkludohet se faktorët kryesorë për mos arkëtimin e shumave për zhdëmtim për periudhat e paraqitura janë:

- ✓ Ndërprerja e marrëdhënieve të punës nga disa punonjës, për të cilët është kërkuar zhdëmtimi i dëmeve.
- ✓ Ka auditime që zbatimi i rekomandimeve lidhet me kohën e përcaktuar që do të vijojë do të kryhet në Janar-Shkurt 2024.
- ✓ Mangësi në marrjen dhe dorëzimin e detyrës.
- ✓ Nëpunësit Autorizues, nuk vijojnë menjëherë procesin që lidhet me urdhër zhdëmtimet.
- ✓

Gjithsesi arkëtimet nga shumat e rekomanduara për zhdëmtim dëmi, arrijnë në masën 72%
Përveç gjetjeve nga pikëpamja financiare në auditimet e zhvilluara, ka edhe gjetje në fushën operacionale dhe të proceseve kryesisht:

- Procedurave të inspektimeve, efektivitetit të masave administrative të aplikuara për subjektet e konstatuar me shkelje të kërkesave ligjore, në fushën e sigurisë ushqimore.
- Realizimit të planit të inspektimeve dhe marrjes së mostrave, si në terren por edhe në PIK,
- Në procedurat e notifikimit të etiketave.
- Në mos kryerjen e inspektimeve, për verifikimin e detyrave të lëna për OBU-të, nga inspektimet e mëparshme.
- Në çështje që kanë të bëjnë me administrimin e masave administrative në formën e gjobës, si dhe ndjekjes së tyre për arkëtim.
- Efekte negative për masa admnistrative të cilat konsiderohen të parashkruara.

Si gjetje tjetër që evidentohet nga misionet e auditimeve janë konstatuar edhe gjetje, pa dëm ekonomik, respektivisht"

- Në përllogaritje të gabuara të amortizimit të aktiveve afat gjatë, respektivisht sipas DRAKU-ve;
- Në procesin e vlerësimit të aktiveve që propozohen për dalje nga përdorimi
- Në shkeljen e disiplinës financiare, për rastet e mos paraqitjes në librat e kontabilitetit të të drejtave (debitor)
- Gjetje për shkelje të disiplinës financiare që kanë të bëjnë me kontabilizim të gabuar të llogarive të aktiveve.
- Efekte negative për masa admnistrative të cilat konsiderohen të parashkruara.

Tabela nr. 7: Gjetjet me efekte negative

Drejtoritë Rajonale	Përllogaritje të gabuara të amortizimit	Kontabilizim të gabuar të aktiveve	Vlerësimin i parregullt i aktiveve	Gjoba të parashkruara dhe moskuadrime me thesarin	Pasqyrim i gabuar i gjendjes së magazinës në bilanc	Debitor të pa pasqyruar në Bilancin kontabël
DRAKU Korçë	0	50,300	162,412	1,850,000	0	0
DRAKU Tiranë	0	285,450	718,910	0	0	346,650
DRAKU Berat	0	0	0	0	0	0
DRAKU Vlorë	0	0	157,684	0	0	0
DRAKU Elbasan	60,757	156,000	1,128,444	0	0	0
DRAKU Gjirokastër	23,927	132,680	456,264	583,480	491,220	0
DRAKU Fier	0	373,392	863,086	0	0	0
Totali	**84,684**	**997,822**	**3,486,800**	**2,433,480**	**491,220**	**346,650**

V. DETYRIMET E PRAPAMBETURA

Sa i takon detyrimeve të prapambetura, nga auditimet është konstatuar se njësitë e vartësisë përgjithësisht, nuk kanë krijuar detyrime të prapambetura, *por është konstatuar se në një Njësi Vartësie ka krijuar një detyrim të prapambetur mbi 60 ditë, por që më pas janë likujduar, brenda vitit ushtrimor.Evidentojmë se kjo ka ndodhur edhe për mungesë të NA dhe njëkohësisht shumat përkatëse kanë qenë të vogla për blerje dhe shërbime.*

VI. VLERËSIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Gjatë auditimeve për periudhën raportuese për të gjithë subjektet e audituara është bërë vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, duke identifikuar fushat dhe sistemet të cilat nuk kanë funksionuar siç duhet, si dhe duke evidentuar problematika dhe njëkohësisht i është bërë e qartë menaxhimit, sistemet apo fushat që duhet të përmirësohen në vijimësi. Pothuajse në të gjithë programet e auditimit kanë në përmbajtjen e tyre si pikë të veçantë edhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Subjektet e audituara janë vlerësuar pothuajse për të gjithë komponentët kryesor të funksionimit të kontrollit të brendshëm:

1- Mjedisi i kontrollit;
2- Menaxhimi i riskut;
3- Aktivitetet e kontrollit;
4- Informacioni dhe komunikimi;
5- Monitorimi.

Nga stafi auditues për subjektet e audituara janë dhënë opinionet dhe është rekomanduar menaxhimit, që ti inkurajojë punonjësit për të krijuar së bashku një kulturë organizative, e cila mbështet realizimin e objektivave dhe ndihmon në formimin e një qëndrimi pozitiv në menaxhimin e gjithë niveleve. Përgjithësisht subjektet e audituara për vitin 2023, karakterizohen nga integriteti profesional relativisht të kënaqshëm si në marrjen e vendimeve por edhe në kryerjen e detyrave në vijimësi. Struktura organizative ka qënë në përgjithësi në pajtim me funksionet e ngarkuara sipas kuadrit ligjor. *Disa vakanca të konstatuara nga auditimi që kanë sjellë vështirësi në punët e përditshme operative të subjekteve të audituara nga ana e njësisë audituese i është prezantuar menaxhimit të lartë për marrjen e masave përkatëse.*

Nisur nga problematikat e identifikuara janë dhënë dhe rekomandimet për menaxhimin për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve si:

- Të mbështesë kontrollin e brendshëm dhe të vendosë rregulla e procedura të qarta e të përshtatshme dhe veçanërisht të monitorojë zbatimin e tyre.
- Përcaktimin e qartë të ndarjes së detyrave, detyrimeve dhe përgjegjësive për punonjësit.
- Të vendosë një hierarki të përshtatshme dhe linja efektive raportimi.
- Të identifikojë nevojat e stafit për trajnime, kualifikime që synojnë përgatitjen e tyre në nivel më të lartë për kryerjen e detyrave të caktuara.
- Të hartojë regjistrin e riskut dhe strategji për menaxhimin e tij dhe njëkohësisht ta përditësojë atë rregullisht.
- Të raportojë risqet që lidhen me mosrespektimin e legjislacionit, ose të procedurave në fuqi që rregullojnë aktivitetet buxhetore, financiare dhe ekonomike, por veçanërisht me fokus, në fushat operacionale. që kanë të bëjnë me sigurinë ushqimore**.**
- Të raportojë dhe të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e situatës dhe kur është rasti të propozojë masat administrative/disiplinore të nevojshme.
- Të ndërmarrë nismat e nevojshme për ndërhyrje në aktet rregullative, të cilat do ti shërbejnë garantimit të sigurisë ushqimore apo edhe proceseve të tjera.
- Të vendosë procedura për dokumentimin, arkivimin, ruajtjen e dokumentacionit dhe informacionit, si dhe të ndjekë procesin.
- Të monitorohet marrja dhe dorëzimi i detyrës, duke mos u kufizuar vetëm në dorëzimin e bazës materialeve (aktivet në ngarkim), por edhe dokumentacionit.

Për periudhën raportuese në përgjithësi njësia e AB-së ka gjetur përkrahje nga menaxhimi dhe është rënë dakord për masat rekomanduese si dhe për planet e veprimit. Gjithsesi, është konstatuar se nga Menaxhimi i Lartë në subjektet e audituara, nuk bëhen sqarimet për të gjithë punonjësit, por edhe përfshirjen e tyre, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve. Konstatohen se ka mendësi se zbatimi i rekomandimeve është detyrë vetëm e disa sektorëve dhe nuk është detyrë që përfshin shumë struktura apo punonjës. Nisur nga këto, auditi ka dhënë rekomandime të detajuara, me qëllim përfshirjen e të gjithë punonjësve, si pjesë e kontrollit të brendshëm, vecanërisht në planet e veprimit të sugjeruara.

Si një komponent shumë i rëndësishëm i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, është edhe Monitorimi, ku nga auditimet e zhvilluara, është konstatuar se ky element nuk funksionon, ose funksionon me mangësi të theksuara, në disa njësi vartësie, por edhe në Drejtorinë Përgjithshme.

Opinioni i Vlerësimit të Sistemit të Kontrolleve të Brendshëm	Përshkrimi i Opinionit, baza e Opinionit
Sistemi i Kontrollit te Brendshdm funksionon nd m6nyre efektive, por u gjeten disa mangdsi, tE cilat kane apo mund td kend ndikim t€ moderuar ne objektivat e njesise publike. Ka nevoje per marjjen e veprimeve per permiresime ne disa **Portokalli**	Gjatë ushtrimit të funksionit të njësisë së auditimit të brendshëm në të gjithë aktivitetin e Drejtorive Rajonale të AKU-ve, është përfshirë vlerësimi dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm (të pestë komponentët), klasifikimi, mënyra e operimit dhe efektiviteti i tij. Ky drejtim i auditimit të brendshëm duhet parë me përparësi nga menaxherët respektive, për vetë faktin se mosfunksionimi i kontrollit të brendshëm, ka sjellë pasojë prezencën e risqeve dhe ndikimin e tyre në arritjen e objektivave strategjikë të Drejtorive Rajonale të AKU-ve. Ndër faktorët kryesor të evidentuara nga NjAB, të cilët kanë sjellë si pasojë mosfunksionimin e plotë të sistemeve të kontrollit të brendshëm janë: 1- Ndryshimi i shpeshtë i stafit në nivel Menaxherial dhe specialist; 2- Vakancët e herë pas hershme në strukturën organizative të njësive të audituara; 3- Monitorim jo i kënaqshëm për proceset; 4- Informacioni dhe komunikimi në shumë raste jo shterues. Në drejtoritë ku auditimi i brendshëm ka identifikuar dhe përcaktuar risqet kryesore, është informuar drejtuesi rajonal rreth fushave me risk ku ka nevojë të ndërmerren veprime të mëtejshme, si dhe është rekomanduar organizata për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përcaktimin sa më të qartë të përgjegjësive, për të menaxhuar risqet me qëllim frenimin dhe minimizimin e tij, rishikimin dhe rishqyrtimin rregullisht të kontrolleve respektivë.

VII. REKOMANDIMET

VII.1 Rekomandimet e propozuara nga auditi i brendshëm

Gjatë ushtrimit të funksionit dhe veprimtarisë së saj njësia e AB i ka kushtuar një rëndësi të veçantë momentit të dhënies së rekomandimeve me synimin përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe veprimtarisë së subjekteve të vartësisë për arritjen e objektivave. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe i veprimtarisë së tyre është shoqëruar me dhënien e rekomandimeve të cilat vlerësohen profesionale, koncize dhe të zbatueshme. Rekomandimet e dhëna nga njësia e AB kanë qenë një vlerë e shtuar në veprimtarinë e subjekteve të vartësisë, duke ndihmuar kështu në arritjen e objektivave të tyre dhe rritjen e performancës, me qëllim përmirësime për të ardhmen. Në përgjithësi rekomandimet e dhëna gjatë vitit 2023 do të klasifikoheshin sipas grupeve të mëposhtme:

- ✓ Rekomandime për përmirësimin e akteve rregullative
- ✓ Rekomandime për përmirësimin e sistemeve;

- ✓ Rekomandime për masa organizative;
- ✓ Rekomandime për masa zhdëmtim dëmi.

Rekomandimet e dhëna nga Sektori i AB kanë qenë të lidhura kryesisht me përcaktimin e rrugëve dhe drejtimeve që mundësojnë mbylljen e veprimeve jo në përputhje më aktet rregullative, ndreqjen e parregullsive si dhe evidentimin e shkaqeve dhe përgjegjësive më qëllim shmangien e tyre në vijim. Për çdo shkelje, apo parregullsi të konstatuar nga ana e njësisë së AB është përcaktuar saktë shkelja duke cituar referencat ligjore përkatëse si dhe i është dhënë prioritet rekomandimeve, për përmirësimet e nevojshme.

Për vitin 2023 nga stafi auditues, për subjektet e audituara janë dhënë gjithsej **204** rekomandime që kanë të bëjnë me masa për përmirësimin e akteve rregullative, masa organizative, masa për përmirësimin e sistemeve, si dhe masa zhdëmtim dëmi. I gjithë totali i gjetjeve me dëm ekonomik është lënë për zhdëmtim nga auditi si rekomandim.

Tabela nr. 8: Rekomandimet e dhëna për çdo subjekt të audituar

Drejtoritë e audituara	Rekomandime për përmirësimin e sistemeve	Rekomandime për masa organizative	Rekomandime për masa zhdëmtim dëmi	Rekomandime për përmirësimin e akteve rregullative	Totali i rekomandimeve
DRAKU Berat	0	4	5	0	9
DRAKU Elbasan	7	32	2	1	42
DRAKU Vlorë	5	10	0	0	15
DRAKU Tiranë	4	39	5	0	48
DRAKU Korçë	0	17	5	0	22
DRAKU Gjirokastër	2	35	6	0	43
DRAKU Fier	0	22	3	0	25
Totali	**18**	**159**	**26**	**1**	**204**

Grafiku nr. 3: Numri i rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2023 sipas subjekteve të audituara.



- ***Nisur nga risku që mbartin dhe përfaqësojnë 204 rekomandimet e dhëna më poshtë paraqiten sipas prioriteteve;***

Grafiku nr. 4: Rekomandimet e dhëna sipas riskut.



Grafiku nr. 5: Rekomandime sipas sistemeve dhe fushave ne përqindje.



Të dhënat kryesore mbi treguesit vjetor për rekomandimet e dhëna gjatë auditimit janë të detajuara në anekset dhe tabelat bashkëlidhur raportit. Në vijim paraqitet ecuria e treguesve mbi rekomandimet e dhëna dhe performanca e punës audituese krahasuar me vitet e mëparshme.

VII.2 Treguesit rekomandime/auditime viti 2023

Për vitin 2023 janë kryer gjithsej 7(përvec auditimit për zbatimin e rekomandimeve për vitet 2021-2022) auditime dhe janë dhënë në total 204 rekomandime me një mesatare prej rreth 29 rekomandimesh për auditim. Rekomandimet janë përqendruar në anën cilësore, përmbledhëse dhe koncize duke mos rënë në ripërsëritje në mënyrë që subjektet e audituara ti kenë lehtësisht të zbatueshme ato. Duhet theksuar se gjatë trajtimit të çështjeve në raport, janë dhënë detaje për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve me qëllim që rekomandimi të kuptohet si dhe të jetë i zbatueshëm. Në fund të çdo raporti, rekomandimet e natyrës për të cilat janë dhënë detaje në raport kanë qenë koncize dhe është dhënë edhe referenca përkatëse e raportit në të cilin çështja është trajtuar. Përshkrimi i detajuar i mënyrës së zbatimit të rekomandimeve, është bërë edhe për faktin se në subjektet e audituara është konstatuar se ka pasur keqkuptime në procese, akte rregullative si dhe mangësi në numrin e punonjësve dhe lëvizjen e tyre të shpeshtë por edhe në procedurat e marrjes dhe dorëzimit të detyrës.

Në lidhje me rekomandimet e dhëna për periudhën raportuese, situata për zbatimin e tyre paraqitet:

Tabela nr. 9: Rezultatet e zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2023

Drejtoritë e audituara	Total Rekomandime	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar	Pa pranuar
DRAKU Berat	9	7	1	1	0
DRAKU Elbasan	42	17	14	11	0
DRAKU Vlorë	15	9	3	3	0
DRAKU Tiranë	48	33	13	2	0
DRAKU Korçë	22	9	8	5	0
DRAKU Gjirokastër	43	5	38	0	0
DRAKU Fier	25	0	25	0	0
Totali	**204**	**80**	**102**	**22**	**0**

Grafiku nr.6: Statusi i zbatueshmërisë së rekomandimeve.



Për vitin 2023 janë dhënë gjithsej 204 rekomandime. Nga verifikimi i tyre nëpërmjet planeve të veprimit, rezulton se:

- 80 rekomandime ose 39% e totalit të rekomandimeve të dhëna janë zbatuar;
- 101 rekomandime ose 50 % e totalit të rekomandimeve të dhëna janë në proces zbatimi;
- 23 rekomandime ose 11% e totalit të rekomandimeve të dhëna janë pazbatuar.

Siç shikohet nga rezultatet e paraqitura në tabelë dhe grafik, nga njësia e auditimit të brendshëm vlerësohet se rezultati prej 12% që përfaqëson rekomandime të pazbatuara, mbetet një problem nga menaxhimi në Drejtoritë Rajonale për zbatimin e plotë të tyre
Konstatohet gjithashtu se 50% e rekomandimeve janë në proces zbatimi,
NJAB, do të vazhdojë të ketë në fokusin e saj, ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve në vijimësi, duke i verifikuar ato jo vetëm në çdo mision auditimi, por edhe duke ndërmarrë misione të veçanta, sipas rasteve.

Në lidhje moszbatimin e rekomandimeve vlerësohet se disa nga shkaqet e mosrealizimit të tyre janë:

1. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës për ish-Drejtues dhe punonjës, shumat debitore të cilëve kanë pasur vështirësi në arkëtim për shkak edhe të largimit të tyre.
2. Neglizhencë nga menaxhimi i subjektit të audituar, mos kërkesë llogarie për strukturat vartëse si dhe mos ndjekjen me përgjegjësi të rekomandimeve të dhëna.
3. Mungesa e bashkëpunimit me struktura të caktuara në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së.
4. ***Disa rekomandime janë në proces zbatimi për shkak se auditimet kanë përfunduar rreth fundit të vitit 2023, ato do të zbatohen në vijim sipas afateve të dhëna (DRAKU/Gjirokastër dhe DRAKU/Fier.***
5. Një pjesë e stafit të Nëpunësve Zbatues, janë të rinj në detyrë.

6. ***Disa rekomandime janë në proces zbatimi, sepse zbatimi i tyre lidhet me paraqitje e tyre në Bilancin kontabël të vitit 2023.***

Për vitin 2023 rezulton se nuk ka rekomandime të pa pranuara.
Gjithashtu konstatohet se nuk ka argumentime ligjore apo shkaqe të tjera të arsyeshme për mos zbatimin e rekomandimeve, të paktën dhe pjesërisht. Auditi me qëllim zbatimin e plotë të rekomandimeve të dhëna me asistencën e tij ka dhënë konsulencën e nevojshme Drejtorive Rajonale, veçanërisht atyre që kanë vlera monetare për zhdëmtim dëmi, por edhe për rekomandimet e tjera Përgjithësisht njësia e AB ka gjetur mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e njësive të audituara për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për zbatimin e plotë të rekomandimeve.
Nga NJAB është bërë e qartë se zbatimi i rekomandimeve, është përgjegjësi e Organizatave të audituara dhe jo e NJAB. Kjo edhe në rastet kur mos zbatimi i tyre është për shkak se organizata pranon në një nivel të caktuar riskun.

VIII. ANKETA PËR REAGIMET NGA AUDITIMI.

Në zbatim të urdhrit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", subjekteve të audituara për vitin 2023, ju është dërguar **anketa për reagimet nga auditimi (Formati Standard nr. 6).** Kësaj ankete i janë përgjigjur të 6 (gjashtë) subjektet e audituara.
Pyetjet vlerësohen nga 1 në 4 për disa komponentë, respektivisht,

1- Shumë të kënaqur
2- Të kënaqur
3- Të pakënaqur
4- Shumë të pakënaqur

Nga vlerësimi i kryer për auditin e brendshëm ka rezultuar se:

Tabela sipas subjekteve të audituara

Shkalla e vlerësimit: 1- Shumë të kënaqur, 2- Të kënaqur, 3- Të pakënaqur, 4- Shumë të pakënaqur						
KOMPONENTËT E PERFORMANCËS	**DRAKU BERAT**	**DRAKU ELBASAN**	**DRAKU VLORË**	**DRAKU TIRANË**	**DRAKU KORÇË**	**DRAKU GJIROKASTËR**
PLANIFIKIMI I AUDITIMIT						
Sa të kënaqur jeni që:						
1. Ju janë dhënë mundësi të përshtatshme për të rënë dakord në fushën veprimin e auditimit para se të fillonte?	1	1	1	1	1	1
2. Ju është dhënë njoftimi i duhur për kohën dhe kohëzgjatjen e auditimit ?	1	1	1	1	1	1
KRYERJA E AUDITIMIT						
Deri në çfarë mase jeni të kënaqur që:						

3. Audituesit e brendshëm kanë qenë profesionalë dhe të sjellshëm gjatë kryerjes së auditimit?	1	1	1	1	1	1
4. Audituesit e brendshëm kishin njohuri të mjaftueshme në fushën e veprimtarisë tuaj?	1	1	1	1	1	1
5. A ju është komunikuar në mënyrën e duhur progresi i angazhim auditimit, duke përfshirë detajet e çështjeve kryesore që u shqyrtuan?	1	1	1	2	1	1
RAPORTIMI I REZULTATEVE TË AUDITIMIT						
Sa të kënaqur jeni që:						
6. Raporti është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar?	1	1	1	1	1	1
7. Projekt Raporti është prezantuar në mënyrë të qartë në lidhje me formatin dhe qartësinë e gjuhës së përdorur?	1	1	1	1	1	1
8. Pas përgjigjeve të menaxhimit për komentet, raporti përfundimtar është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar ?	2	1	1	2	1	1
9. Rekomandimet ofruan zgjidhje praktike dhe konstruktive për çështjet e identifikuara ?	2	1	1	1	1	1
10. Argumentimi për gjetjet dhe përfundimet e auditimit a janë shpjeguar në mënyrë të kënaqshme, komentet/ pikëpamjet tuaja a janë marrë parasysh ?	2	1	1	1	1	1
CILËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM						
Sa të kënaqur jeni që:						
11. Zbatimi i rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimeve të risqeve, të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes ?	2	1	1	2	1	1
12. Auditimi ju ofroj informacionin që do t'ju ndihmojë për të përmbushur përgjegjësitë e raportimit tuaj të sigurimit të cilësisë ?	2	1	1	1	1	1
13. Auditimi i brendshëm kontribuon në përmirësimin organizativ për arritjet e objektivave strategjike në njësinë tuaj publike ?	2	1	1	1	1	1
SHËRBIME TË TJERA TË OFRUARA NGA AUDITIMI I BRENDSHËM						
14. A jeni të vetëdijshëm se njësia e auditimit të brendshëm ofron shërbime këshillimi ?	2	1	1	2	1	1
15.Nëse ju keni përdorur shërbimet e këshillimit të ofruara nga auditimi i brendshëm, a jeni të kënaqur me kontributin e dhënë ?	1	1	1	2	1	1
Vlerësimi mesatar sipas DRAKU-ve	**1.5**	**1**	**1**	**1,3**	**1**	**1**

IX. MONITORIMI I SISTEMIT DHE SIGURIMI I CILËSISË SË AUDITIMIT

NJAB, në zbatim të manualit të AB, si dhe rekomandimeve të dhëna nga NJQH, ka miratuar programin e sigurimit të cilësisë, me shkresën nr.3208/1 datë 01.09.2021

Gjatë vitit 2023, procesi i sigurimit të cilësisë gjatë fazës së auditimit dhe gjatë hartimit të raportit përkatës, është kryer nga përgjegjësi i grupit të auditimit. Njëkohësisht nga drejtuesi i njësisë së AB është plotësuar rregullisht raporti përkatës dhe formati standard nr. 14 (lista verifikuese e evadimit të auditimit), duke vlerësuar se letrat e punës dhe raporti janë të sakta, objektive, të qarta dhe se programi është i realizuar dhe rekomandimet janë të argumentuara. Gjithashtu është plotësuar dhe formati përkatës (përgjegjësitë e rishikimit të punës nga drejtuesi i njësisë së auditimit respektivisht:

a. Në lidhje me planin misionin e auditimit.
b. Në lidhje me procedurat për realizimin e auditimit.
c. Dokumentimi i punës së auditimit.
d. Në lidhje me raportimin e auditimit.

Pasi është kryer një siguri e arsyeshme e standardeve e programit të punës dhe rekomandimeve të dhëna, janë hartuar memorandumet për menaxhimin e lartë (Drejtori i Përgjithshëm). Në Memo është dhënë opinion për vlerësimin e procedurave, cilësinë e auditimit dhe rekomandimet apo masat e propozuara për subjektin e audituar. Nga shqyrtimi për sigurimin e cilësisë për dosjen e auditimit, rezulton se ato janë konform standardeve dhe praktikave profesionale të auditimit, më konkretisht:

- Janë dhënë opinione profesionale të mbështetura në gjykime objektive;
- Raportet e auditimit janë përgatitur me standarteve.
- Janë dhënë rekomandime profesionale dhe cilësore si në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit ashtu edhe në drejtim të zbatimit të procedurave dhe përmirësimit të veprimtarisë së inspektimit në operatorët e biznesit ushqimor, në kuadër të sigurisë ushqimore dhe të mbrojtjes së konsumatorit, pasi ky është dhe qëllimi kryesor i institucionit të AKU-së.
- Janë dhënë rekomandime të rëndësishme për fusha dhe sisteme të cilat, nuk ishin audituar për një periudhë të gjatë kohe, rekomandime që kanë të bëjnë kryesisht me veprimtaritë operacionale.
- Dosjet janë të plotësuara me të gjithë formularët standard në zbatim të manualit të auditimit të brendshëm.

Megjithatë kërkesat për përmirësimin e cilësisë dhe zbatimit të standardeve të auditimit, janë kërkesa që nuk mbeten statike dhe në këtë kontekst ka vend për përmirësime të vazhdueshme.

X. ANALIZA E KAPACITETEVE AUDITUESE

X.1 Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB

Njësia e auditimit të brendshëm në AKU, është ngritur, që në krijimin e këtij institucioni në muajin mars 2010. Veprimtaria audituesi ka nisur në vitin 2011. Në vitet 2010, 2011 dhe deri më datë 1 qershor 2012, në përbërje të strukturës së AB-së, kanë qenë dy punonjës respektivisht një përgjegjës sektori dhe një inspektor. Me strukturën e miratuar (VKM nr.54, datë 09.05.2012) struktura e auditit është miratuar me tre punonjës, një përgjegjës sektori dhe dy inspektorë. (1+2). Gjatë vitit 2023, nuk janë konstatuar probleme në lidhje me funksionimin e njësisë së auditimit të brendshëm. Burimet e auditimit janë përdorur në përputhje me auditimin. Në shërbimin efektiv vjetor kanë marrë pjesë i gjithë stafi i Sektorit të Auditimit, përfshirë në grup auditimit në c'do rast

(mision) edhe Drejtuesin e Njësisë së Auditimit, i cili ka qenë edhe në rolin e përgjegjësit të grupit, me përjashtim të misionit për *"Auditimin e zbatimit të rekomandimeve"*. Infrastruktura dhe mjetet e punës së auditit të brendshëm në disa raste nuk kanë qenë në ndihmë për të ndihmuar në realizimin e misionit të auditimit, nga pikpamja kohore. Kjo për faktin se laptopët që ishin në përdorim nga të gjithë punonjësit e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, kanë dalë nga përdorimi rreth 2 vjet më parë dhe nuk ka një furnizim të ri për këtë, duke krijuar vështirësi në ecurinë normale të punës.

Nga NJAB, është ndjekur me prioritet të lartë rekomandimet që kanë të bëjnë me gjetjet në aspektin e rritjes së sigurisë Ushqimore, si dhe aspekteve financiare, për të cilat janë rekomanduar masat përkatëse dhe masa zhdëmtim dëmi. Ndërkohë ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, për fusha të tjera, është kryer duke marrë planet e veprimit, si dhe dokumentacionin përkatës, por siç kemi theksuar, për këtë do të ndërmerret një mision i veçantë auditimi, për të evidentuar në mënyrë më të plotë, situatën e statusit të zbatimit të rekomandimeve.

Në lidhje me evidentimet e statusit të zbatimit të rekomandimeve, konstatohet shpesh statusi i tyre, nuk perputhet me formatet që plotësohen nga ana jonë. Kjo për faktin se në formate nuk gjejnë vend statuse të tilla si : " ***Zbatuar pjesërisht", "Zbatuar tej afateve" për të cilat sugjerojmë që të parashikohen në formatet raportuese që kërkohen nga NJQHAB.***

Referuar shtimit të fushave dhe sistemeve që auditimi ka përfshirë në planet e auditimit, materialitetit voluminoz të tyre, specifikat teknike etj, vlerësohet se kapaciteti administrativ i njësisë së AB-së me tre punonjës (1 përgjegjës dhe 2 specialist) është i pa mjaftueshëm për të mbuluar subjektet me auditim vjetor. Evidentojmë gjithashtu se numri i përgjithshëm i punonjësve në AKU është rreth 430 i shpërndarë në 12 Qarqe të vëndit dhe në Drejtorinë e Përgjithshme.

Për sa më sipër propozojmë që Sektori i Auditimit të Brendshëm të jetë me 5 punonjës gjithsej duke përfshirë edhe drejtuesin e njësisë.(4+1)

Një problematik e hasur jo vetëm gjatë vitit 2023, është fakti i ndryshimit të emërtimit të funksionit të audituesve. Kështu deri në muajin mars të vitit 2014, audituesit emërtoheshin si ***inspektorë dhe kjo shoqëruar më një pagë të caktuar,*** ndërsa pas muajit mars 2014 dhe në vazhdim audituesit emërtohen si ***specialist,*** duke sjellë si pasojë edhe uljen e nivelit të pagës nga III-b në IV-a. Nisur edhe nga ligji për auditimin e brendshëm Nr. 114 2015, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", si dhe ndryshimi që atij iu bë gjatë vitit 2023 evidentohet se nuk ka një parashikim një status të veçantë si nga pikëpamja e emërtimit por dhe nga pikëpamja e trajtimit material:

Propozojmë që emërtimi i audituesit të mos quhet inspektor apo specialist siç është aktualisht, por thjesht emërtimin auditues, duke përcaktuar një tjetër nivel page, konkretisht nivelin III-B, niveli i mëparshëm, apo nivelet me shkallë sic i ka KLSH.

Kjo kërkesë, ka edhe një argumentim tjetër, e cila ka të bëjë me hyrjen në fuqi të Ligjit 60/2016 "*Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve*" sipas të cilit Sektori i Auditimit është Njësia Përgjegjëse në zbatim të këtij ligji, angazhim ky që kërkon kohën, burimet dhe kapacitetet e nevojshme njerëzore. Gjithashtu, nga ana jonë, janë ndjekur edhe raste denoncimi të cilat kanë kërkuar , kohën e nevojshme, për të kryer procedurat sipas parashikimeve ligjore.

Në zbatim të ligjit 60/2016, NJAB, është njëkohësisht edhe Njësia Përgjegjëse "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve", por siç ka rezultuar ajo nuk ka trajtuar raste sinjalizimi për vitin 2023, sepse nuk janë paraqitur nga punonjës, apo ish punonjës, sinjalizime. Gjithsesi për këtë veprimtari, NJAB në cilësinë edhe të Strukturës përgjegjëse "*Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve"* ka paraqitur edhe Raportin vjetor për vitin 2023, pranë ILDKPKI.

X.2 Kapacitetet audituese

Plotësimi i nevojave me burime njerëzore me integritet por edhe me profesionalizëm, janë elementë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e veprimtarisë audituese. Stafi i njësisë së AB ka përfunduar arsimin e lartë, duke plotësuar kërkesat përkatëse sipas profilit**..** Stafi auditues ka një vjetërsi pune konkretisht:

1- Përgjegjësi i sektorit të AB mbi 30 vite pune dhe si auditues 12 vite pune.
2- Specialist i sektorit të AB 18 vite pune dhe si auditues 13 vite pune.
3- Specialiste e sektorit të AB me 8 vite pune dhe si audituese 3 vite pune.

Drejtuesi i NJAB dhe një auditues janë 100 % të certifikuar sipas ligjit, të cilat janë realizuar në vitin 2011 dhe në vitin 2012, ndërsa specialisti tjetër është certifikuar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në tremujorin e tretë të vitit 2023.

Sic këmi theksuar, në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, ka ndodhur një ndryshim ku një prej specialistëve (specialistia me më pak vite pune në tërësi dhe si auditues) është larguar nga kjo detyrë dhë në vënd të saj është emëruar një specialist tjetër, i cili ka një vjetërsi pune prej 7 vjetësh dhe diplomë universitare të plotë (bachelor+mastër) në shkencat ekonomike. Ndërkohë do të vijohet për fillimin e procesit të regjistrimit për të kryer kursin përkatës të certifikimit, sic parashikon ligji organik i Auditimit të Brendshëm.

Theksojmë se struktura dhe organika e NJAB, përbehet nga 3 punonjës, nga të cilët, 1 P/Sektorit dhe 2 specialistë e cila siç kemi theksuar mbetet e plotësuar.

X.3 Zhvillimi i aftësive dhe ngritja e nivelit profesional të audituesve

Stafi i auditit të brendshëm në AKU, është i punësuar në përputhje me ligjin përkatës si dhe VKM-së nr. 83 datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"*, e ndryshuar. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, janë trajnuar punonjësit e Sektorit të Auditimit të brendshëm përgjithësisht për temat e kërkuara që në planin vjetor dhe strategjik. Trajnimi është kryer për disa temat si:

1. Prokurimi Publik dhe Auditimit i Paternitetit Publik;
2. Auditimi i Asistencës së para anëtarësimit në BE (IPA);
3. Auditimi i Njësive të Vetqeverisjes Vendore;
4. Auditimi i Brendshëm në sistemin e shëndetit publik;

Këto trajnime të realizuar, janë të organizuara nga DHAB-ja pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

- **Analiza e kostove dhe shpërndarja e burimeve**

Gjatë auditimeve të kryera është mbajtur parasysh, që misionet të realizohen me kosto sa më të ulët, pa prekur cilësinë e auditmeve.
Më poshtë tabela në lidhje me planifikimin dhe realizimin e buxhetit të NJAB:

Nr	BURIMET E PLANIFIKUARA		
	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përllogaritja e burimeve
	1	2	3
1	Koha maksimale e vlefshme	780	52 javë X 5 ditë X 3 persona
2	Pushime Vjetore	60	4 javë, 5 ditë X 3 persona
3	Dite pushimi (Festa Zyrtare)	39	13 ditë X 3 persona
4	Pushime për arsye shëndetësore	15	5 ditë X 3 persona
5	Angazhime në trajnime	15	5 ditë X 3 persona
6	Angazhime në mbledhje/takime	15	5 ditë X 3 persona
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	9	3 ditë X 3 persona
	TOTALI	627	206 ditë/person

Nr	BUXHETI I PLANIFIKUAR		
	Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani	Fakti
	1	2	
1	Buxheti Gjithsej	4,295	4,217
2	Paga dhe Sig.Shoqërore	2,975	3,518
3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	1,200	676
4	Të tjera	120	23
5	Numri i Punonjësve	3	3
6	Kosto për Person (1/3)	1,432	1,406

Sic vërehet rezulton se buxheti i realizuar është në masën 98%, por buxheti i faktit në lidhje me pagat ka pësuar ndryshim në rritje, krahasuar me planifikimin ku ndikimi është 543mijë lekë dhe nëse nuk do të ishte kjo rritije page, buxheti faktik do të ishte në masën 60%

XI. KONKLUZIONE

XI.1 Konkluzione mbi problematikën e punës audituese dhe arritjet

Në referim të misioneve të angazhimit të realizuara gjatë vitit 2023, konkludohet se në përgjithësi, në subjektet e audituara janë konstatuar problematika si në Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, por edhe në proceset e tjera të aktiviteteve. Me gjithë zhvillimin dhe ecurinë që ka pasur sistemi i kontrollit të brendshëm veçanërisht me rekomandimet e dhëna nga ana jonë, mbetet një problem

akoma shqetësues pasi ky sistem nuk është i njohur plotësisht nga menaxherët e subjekteve të audituara (nëpunësit autorizues dhe zbatues). Ai ka sjellë pasojë në konceptim jo të plotë të rolit dhe misionit të auditimit të brendshëm si pjesë përbërëse e këtij sistemi. Vihet re se auditi është parë si një njësi ndëshkuese dhe jo si një njësi që shton vlerën e institucionit dhe shërben, duke ndihmuar titullarin e institucionit për arritjen e objektivave të organizatës, jo vetëm në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit por në të gjithë veprimtarinë e institucionit. Në përgjithësi vihet re një frymë pritshmërie në lidhje me të gjithë problematikat, nuk konstatohen vetë veprime, iniciativa nga menaxherët e subjekteve të audituara për të ndryshuar situata të cilat konstatohen nga ana e auditit, apo edhe kontrolle të tjera nga struktura të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së. E njëjta situatë është edhe në raport me masat disiplinore. *Mungojnë fillimet e ecurive*

disiplinore nga Drejtorët Rajonal, për punonjës të caktuar megjithëse auditi ka përcaktuar qartë shkeljet për gjithsecilin. Nuk konceptohet në mënyrë të drejtë, që raporti dhe konkluzionet e auditimit duhet të shërbejnë si bazë për marrjen e masave organizative ashtu edhe për marrjen e masave administrative. Ne vlerësojmë si të rëndësishëm krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për kuptimin dhe konceptimin e sistemeve të tilla të reja për nivele të ndryshme të menaxhimit, e cila do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e ndërgjegjësimin dhe kuptimin e saktë dhe të plotë të rolit e misionit të auditimit të brendshëm, si mbështetje dhe si ndihmë për menaxhimin e organizatave në përmbushje të detyrave dhe objektivave të caktuara. Në fokus dhe në vëmendje kryesore të auditimit të brendshëm në vijim do të jetë ndjekja e problemeve dhe nxitja e veprimeve konkrete në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe rregullat në fuqi për të gjitha organizatat objekt auditimi i AKU-së. Njësia e auditimit të brendshëm për vitin 2023 ka patur arritje dhe performancë të mirë në punën e saj.

Si arritje për vitin 2023 paraqesim:

- Rekomandimet e dhëna plotësojnë të gjithë hierarkinë e tyre, duke filluar nga rekomandimet për përmirësimin e akteve rregullative , me rekomandimet për përmiorësimin e sistemeve, me rekomandimet organizative si dhe ato me zhdëmtim dëmi.
- Masat zhdëmtim dëmi ka arkëtime të kënaqshme, në masën 71 % dhe arkëtimet vijojnë.
- Rekomandimet kanë qenë jo vetëm në drejtime të menaxhimit financiar dhe kontrollit, por edhe në drejtim të forcimit të sigurisë ushqimore(proceseve)
- Vlerësimet e risqeve sipas planit vjetor dhe stradegjik , kanë rezultuar korrekte, për faktin se në fushat me risk të lartë, por edhe të mesëm kanë rezultuar gjetje.
- Stafi i NJAB, është i certifikuar
- Janë ndjekur në vijimësi trajnimet e organizuara nga NJQH.
- Kostot e misioneve të auditimit kanë qenë më të ulta se planifikimi

Planet e auditimit kanë përfshirë jo vetëm fushat e auditimit financiar por edhe fushat e tjera që kanë të bëjnë me qëllimin dhe objektivat e institucionit, veçanërisht në kryerjen e procedurave të inspektimeve për sigurinë ushqimore.
Njësia e AB ka pasur një bashkëpunim me struktura të tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së për të trajtuar probleme të veçanta dhe teknike në mënyrë që rekomandimet e dhëna të jenë sa më efikase, koncize dhe të zbatueshme.
Në disa raste nga NJAB është vënë në dispozicion edhe raporti i auditimit, strukturave të veçanta të Drejtorisë Përgjithshme, me qëllim njohjen sa më të mire të problematikave të konstatuara dhe marrjen e masave për përmirësim, për Organizatat e vartësisë.
Përgjithësisht konstatohet se ditët e qëndrimit në subjekt janë pothuajse të njëjtat me vitin paraardhës por në këtë çështje auditi ka pasur në përgjithësi referencën për të kryer misionin me shpenzime të reduktuara, duke shfrytëzuar maksimalisht ditët e qëndrimit në subjekt. Një arritje tjetër mendojmë se është dhe mënyra e dhënies së rekomandimeve pasi ato janë dhënë në formën e trajtimit të procedurave sipas fushave dhe sistemeve të audituara. Vlen të theksohet se vihet re se në misionet e auditimit, ka pasur shumë elementë të trajtimit të përformancës dhe këshillimit

duke bërë kështu një kombinim të llojeve të auditimit. Ky kombinim ka sjellë si pasojë kuptimin më të qartë të të gjithë procesit të auditimit dhe rekomandimeve të dhëna, nga ana e subjekteve të audituara.

XI.2 Prioritetet për vitin e ardhshëm

- Organizimin dhe kryerjen e auditimeve konform planit vjetor të miratuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të auditimit
- Kryerjen e auditimeve me efektivitet dhe paanshmëri, profesionalizëm dhe me efektshmëri më të lartë.
- Sigurimin e cilësisë së auditimit nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të mbikëqyrjes dhe rishikimit gjatë çdo angazhim auditimi.
- Raportimi dhe ndjekjen e veprimtarive pasuese për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve nga ana e njësive të audituara. Ndjekjen e zbatimit te rekomandimeve, në mënyrë intensive duke vlerësuar edhe ndërmarrjen e një misioni të posaçëm, për njësitë e vartësisë për verifikimin e zbatimit të tyre, sipas rasteve specifike.
- Përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve me synim zbatimin e tyre nga njësitë e audituara.
- Vlerësimin e detyrimeve të prapambetura, në njësitë e vartësisë dhe ndjekjen e debitorëve.
- Bashkëpunimin me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme për të gjithë problematikat që konstatohen në Drejtoritë e vartësisë.
- Ngritjen profesionale të stafit auditues si nëpërmjet ndjekjes së trajnimeve të vijueshme nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe Organizatat e BE-së (BTSF ACADEMY, EFSA etj.) por edhe përpjekjeve të vazhdueshme për njohjen me aktet e reja ligjore që dalin në vazhdim.
- Bashkëpunimi me menaxhimin e lartë për të ndërmarrë masat e nevojshme organizative dhe administrative për çështjet që konstatohen gjatë zhvillimit të misioneve të auditimit.
- Shmangjen e përfshirjes së audituesve në cështje operacionale të organizatës.

Bashkëlidhur raportit vjetor, tabelat përkatëse të cilat kanë të dhëna mbi veprimtarinë e sektorit të AB për vitin 2023 si dhe të dhënat analitike për përbërjen profesionale të punonjësve dhe nivelin e kualifikimit.

Përgjegjës Sektori i Auditimit të Brendshëm